




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCE PROTIV KORRUPTIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Nr. Iraç	
Broj Stranica	<u>02</u>
Nr. pages	
Nr. Prot	<u>01-1048/15</u>
Bri Prot	
Prot No	
Data	<u>08.04.2015</u>
Datum	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 07.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-02-333/15, për zyrtarin z. Mirsad Shkreta, anëtar i Kuvendit komunal të Komunës se Hanit te Elezit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe ka dhen dorëheqje nga pozita e drejtor i QKMF-së "Menduh Kaloshi" në Komunën e Hanit te Elezit, si dhe ka hequr dore nga personi i autorizuar në biznesin e tij privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtaar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-333/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Mirsad Shkreta, anëtar i Kuvendit komunal te Komunës se Hani i Elezit.

Gjatë zhvillimit të procedurës se pari është analizuar informata e deponuar në AKK-së, si dhe është vlerësuar gjendja funksionit publik për zyrtarin z. Mirsad Shkreta, dhe është konstatuar se z. Mirsad Shkreta, anëtar i Kuvendit komunal të Komunës se Hani i Elezit, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, anëtar i Kuvendit komunal të Komunës se Hanit të Elezit është i angazhuar si drejtor i QKMF-së "Menduh Kaloshi" në ketë Komunë si dhe ushtron veprimitari private si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privat e që sipas nenit 65.2 te ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë te nenit 15.1 dhe 16.1 Ligjt për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet papajtueshmëri dhe kufizim ne ushtrimin e funksionit publik dhe konflikt të mundshëm

të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 19.02.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese me datën 17.03.2015 z. Mirsad Shkreta, ka ardhur ne takim ku është takuar me zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezantuar faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin e bazuar për konflikt te mundshëm te interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik.

Z. Shkreta, gjatë takimit te organizuar është pajtuar me gjendjen dhe faktet e prezantuara, por është arsyetuar se nuk ka qen ne njohuri se kjo situatë do te sjell konflikt te interesit dhe qe është ne papajtueshmëri me funksioni e këshilltarit komunal, mirëpo është zotuar se brenda afatit ligjore do ta bej ndryshimin e kërkuar nga AKK-ë, dhe do te marr vendim se ne cilin funksion do te vazhdoj te zhvilloj aktivitet .

Me datën 30.03.2015, kemi marr njoftimin zyrtar nga z. Mirsad Shkreta, ku thuhet se pas konsultimeve me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe me Ministrin e Administrimit te Pushtetit lokal dhe pas kërkësës nga ana e tyre qe te shmanget nga situata e Konfliktit te Interesit ka dhen dorëheqje nga pozita e drejtor i QKMF-së "Menduh Kaloshi" ne Komunën e Hanit te Elezit, si dhe ka bërë ndryshimet e kërkuar ne Biznesin me emër O.S "Dens-m" me numër biznesi 70434201.

Vlerësojmë se pas veprimit te dorëheqjes nga pozita e drejtor i QKMF-së "Menduh Kaloshi" ne Komunën e Hanit te Elezit, si dhe pas largimit nga personi i autorizuar ne biznesin e tij privat me emër O.S "Dens-m" me numër biznesi 70434201, dhe pas rrëthanave te reja te krijuara pas veprimeve ta marruara konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Mirsad Shkreta, anëtar i Kuvendit komunal te Komunës se Hani i Elezit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

